



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 297/3 Prot.

Tiranë, më 17.05.2016

V E N D I M

Nr.55, datë 17.05.2016

“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 43, datë 27.04.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore”, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore,

Vërejt se:

Në zbatim të Vendimit nr. 10, datë 10.02.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.43, datë 27.04.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të kryer në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Të pasqyrohen në Rregulloren e Brendshme të institucionit, parimet dhe rregullat që sanksionohen nga legjislacioni për shërbimin civil, për shkak të përfshirjes së tij në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.
3. Të saktësohet nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit dhe Departamenti i Administratës Publike, rasti i deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen *****, deklaruar mbi numrin e pozicioneve të punës të përcaktuara në strukturë, në sektorin e shërbimeve mbështetëse.
4. Departamenti i Administratës Publike, të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësin *****, në pozicionin “*Ekspert Mjekoligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë*”, duke i shtuar faktin që punonjësi duhet të konsiderohet në periudhë prove.
Njësia përgjegjëse të zbatojë të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë krijimin e kushteve për përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA) dhe përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur për ecurinë e tij.
5. Të përfundojë verifikimi i gjendjes gjyqësore për nëpunësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe të materializohet procesi në dosjen e personelit.
6. Të plotësohet dosja e personelit, në rastet e konstatuara me mungesa, sipas aneksraportit që është pjesë e këtij vendimi.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural, prej 30 ditësh Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të Vendimit nr.43, datë 27.04.2015, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” dhe në Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Kjo procedurë ka filluar me Vendimin nr.28, datë 23.03.2016 të Komisionerit, me anë të cilit u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin e inspektuar në datën **31.03.2016**, kqyri dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, rezultoi se :

- ✓ Në zbatim të rekomandimit të pikës 2 të Vendimit nr. 43, datë 27.04.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, njësia përgjegjëse me shkresën nr.1091, datë 10.07.2015, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë të Drejtësisë, ka kërkuar ndryshim të Rregullores së Brendshme. Duke qenë se institucioni është përfshirë në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, në rregullore është kërkuar të përfshihen parimet dhe rregullat e legjislacionit të shërbimit civil sipas rekomandimit të

Komisionerit. Rregullorja e re nuk është përfunduar akoma nga Ministria e Drejtësisë si organi epror i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

- ✓ Në zbatim të rekomandimit të pikës 3 të vendimit, njësia përgjegjëse i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike revokimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit të punonjësës ***** në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse*”, për shkak të deklarimit mbi numrin e pozicioneve të punës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.

Departamenti i Administratës Publike ka revokuar aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.2158/1, datë 15.08.2015, për nëpunësen ***** në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse*” dhe me aktin nr.2158/29, datë 25.05.2015 ka deklaruar statusin e punësimit për këtë nëpunëse në pozicionin, “*Specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Akteve të Laboratorit*”.

- ✓ Në zbatim të rekomandimit të pikës 4 të vendimit, njësia përgjegjëse i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike revokimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit të punonjësit ***** në pozicionin “*Ekspert Mjekoligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë*” dhe deklarimin e statusit për të në periudhë prove.

Departamenti i Administratës Publike ka revokuar aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.2158/17, datë 15.08.2014, për nëpunësin ***** në pozicionin “*Ekspert Mjekoligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë*” dhe me aktin nr.2158/28, datë 25.05.2015, ka deklaruar statusin e punësimit për këtë nëpunës “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, po në pozicionin e mësipërm.

- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 5 dhe 6, rezultoi se ishte bërë verifikimi i gjendjes gjyqësore dhe ishte plotësuar dosja e personelit me aktet që mungonin (*dëshmi penalteti dhe raporte mjekësore*). Ky dokumentacion ishte administruar në dosjen e personelit.

Sa më sipër, konstatoj se Vendimi nr.43, datë 27.04.2015 , “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore*”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Instituti i Mjekësisë Ligjore**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 43, datë 27.04.2015 ,“*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Mjekësisë Ligjore*”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA